

Në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 82/2018 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 178/2021 dhe 58/2024), Statutin e Universitetit të Tetovës, Statutin e Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit dhe Udhëzuesin me kriteret për realizimin e zgjedhjeve për anëtarët dhe për kryetarin e Kuvendit Studentor të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit, shpallet:

### KONKURS

#### për paraqitjen e kandidatëve për zgjedhjen e anëtarëve të Kuvendit Studentor të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit

- I. Të drejtë për të aplikuar kanë të gjithë studentët që e kanë regjistruar semestrin veror në vitin akademik 2025/2026, duke përfshirë edhe studentët që kanë regjistruar semestrin veror të zbrazët në vitin akademik të lartpërmendur.
- II. Së bashku me Fletaplikimin (formularin), kandidatët dorëzojnë:
  - biografi (CV),
  - vërtetim nga shërbimi për çështje studentore se kandidati e ka regjistruar semestrin veror në vitin akademik 2025/2026,
  - vërtetim për notë mesatare prej së paku 8 për kandidatin për kryetar.
- III. Kandidatët për zgjedhjen e anëtarëve dhe të kryetarit të Kuvendit Studentor të Fakultetit janë të detyruar që personalisht t'i dorëzojnë fletaplikimet me dokumentet përkatëse, përmes arkivit të Fakultetit ose me postë në adresën: Universiteti i Tetovës (Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit) rr. “Ilinden”, p.n., 1200, Tetovë, brenda afatit prej 7 (shtatë) ditëve nga shpallja e njoftimit, respektivisht më së voni deri më 26.06.2026.
- IV. Aplikimet e vonuara dhe të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Tetovë, 18.06.2026

Kryetari i Komisionit Zgjedhor  
Prof. Dr. Xhezar Idrizi

